

TREGIM SUKSESI

Zëri im ka rëndësi



Aldi Hoxha, anëtar i Grupit të Rinjëve për Avokim promovon të drejtat e Personave me Sindromën Doun.

”Unë jam Aldi, jam nga Kosova, Zëri im ka rëndësi!” është sllogani që Aldi Hoxha po mban në duar. Njëzet vjeçari Aldi është anëtar i Grupit të Rinjëve për Avokim që është themeluar nga Down Syndrome Kosova, me qëllim që të përfshij personat me sindromën doun në procese avokimi dhe të ngrisin zërin drejt realizimit të të drejtave të tyre. Down Syndrome Kosova numëron deri në

900 persona me sindromën doun të regjistruar në listat e tyre, duke filluar nga mosha 0 – 50 vjeq, të cilët vijnë nga qytete të ndryshme të Kosovës.

Sot po shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave me Sindromën Doun dhe zyra në Prishtinë po e formalizon Grupin e të Rinjëve për Avokim. Ky Grup përbëhet nga 15 anëtarë të prekur me sindromën doun, të cilët vijnë nga qytete të ndryshme të Kosovës. Misioni i këtij Grupi është thyerja e barrierave dhe e paragjyqimeve në shoqërinë Kosovare, ku përmes vullnetit dhe punës personat me sindromën doun të tregojnë aftësitë e tyre, vullnetarizmin dhe të bëhen pjesë e barabartë e shoqërisë.

Aldi Hoxha së bashku me anëtarët e tjerë të këtij Grupi kalon shumicën e kohës në zyret e organizatës Down Syndrome Kosova duke punuar në projekte të ndryshme: “Unë punoj në Down Syndrome Kosova, por nuk jam vetëm një punëtor i organizatës, kam vendosur të përfshihem edhe në fushën e marrëdhënieve publike, sepse dua t’i informoj njerëzit rreth personave me sindromën doun nëpër emisione të ndryshme televizive, në radio dhe si aktor në skenë. Zëri im ka rëndësi!” thotë Aldi.

Down Syndrome Kosova mbështetet në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.